

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6428
E premte, 1 shtator 2021
çmimi 0.40

KUSH HUMBI DHE KUSH FITOI NË BRUKSEL?

FAQE 2

Shkruan:
Milazim KRASNIQI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA DHE SERBIA KANË ARRITUR MARRËVESHJE PËR TARGAT NË BRUKSEL ■ FAQE 4-5

PAJTOHEN PËR RECIPROCITET TË TARGAVE DHE PËR TËRHEQJEN E NJËSISË SPECIALE NGA VERIU

Pas dy ditësh negociata, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për shtensionimin e situatës në veri. Marrëveshja parasheh reciprocitet në targa në mes të dy shteteve, duke ua mbuluar simbolet shtetërore. Sipas dokumentit trepikësh, njësitet speciale policore të vendosura në pikëkalimet kufitare duhet të largohen bashkë me barrikadat. Qeveria e ka cilësuar si fitore këtë marrëveshje, ndërsa opozita e ka kritikuar, duke thënë se qeveria ka barazuar Policinë e Kosovës me barrikaduesit dhe ka dorëzuar sovranitetin të një palë e tretë. ShBA-ja dhe BE-ja e kanë mirëpritur marrëveshjen



OPINION

NUK BARAZOHET KRENARIA JONË ME NJË GRUSHT BANDITËSH SERBË ■ F. 2

Nga: Muhamet MAVRAJ



AKTUALE



VEPRIMTARI SALI BISLIMI TAKON PRESIDENTIN E ZVICRËS ■ F. 3

GJYKATAT KANË ZGJIDHUR NJË NUMËR TË VOGËL TË RASTEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR ■ F. 6

KATËR VIKTIMA DHE MBI 40 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË ■ F. 5

EKONOMI



BESNIK PULA ZGJEDHET KRYETAR I GRUPIT PUNUES PËR FORMIMIN E FONDIT SOVRAN ■ F. 8

24 VJET NGA PROTESTA STUDENTORE E 1 TETORIT E VITIT 1997 ■ FAQE 3



KTHEHEN NË KOSOVË MBETJET MORTORE TË SHTATË VIKTIMAVE TË MASAKRËS SË REZALLËS ■ FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhep isht
Tetov
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 0
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 300
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
ND, RTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

NDËRTIMTARIA DHE TREGTIA, ME RRIJTJEN MË TË MADHE GJATË TREMUJORIT TË DYTË 2021 ■ F. 8

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin, Kosov,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KUSH HUMBI DHE KUSH FITOI NË BRUKSEL?



Shkruan: Milazim KRASNIQI

1. Themeli i marrëveshjes së përkohshme, që u arrit të enjten, më 30 shtator, në Bruksel, për tabelat e veturave, është se do të punohet në muajt në vijim, për të arritur një marrëveshje të përhershme. Pra, kjo është një marrëveshje e përkohshme, siç ka qenë e përkohshme edhe ajo para saj, e cila, kur skadoi, shkaktoi krizën. Nëse nuk gjendet një marrëveshje e përhershme më vonë, edhe kjo e sotnja mund ta kthejë krizën. Në fakt, marrëveshjet e përkohshme janë në pajtim me konceptin që ka Serbia për institucionet e Kosovës, “institucionet e përkohshme kosovare” (privremene kosovske institucije.) Pra, çdo marrëveshje që e ka karakterin si e përkohshme, është më shumë në favor të Serbisë e më shumë në dëm të Kosovës. Edhe kjo marrëveshje është e tillë.

2. Kjo marrëveshje e përkohshme është në funksion të deskalimit të situatës në pikat kufitare Jarinjë dhe Bërnjak. Pra, qëllimi i ndërmjetësuesve ka qenë të ulet shkalla e rrezikut nga ndonjë incident a konflikt në terren. Rrjedhimisht, marrëveshja e tillë është produkt i presionit të ndërmjetësve, e jo i vullnetit të palëve. Palët, po të kishin vullnet më të mirë, nuk do ta sillnin gjendjen në atë shkallë eskalimi. Edhe elementet e

marrëveshjes së përkohshme janë të ndërmjetësve, e jo të palëve në konflikt.

3. Qeveria e Kosovës do të krenohet se e ka ruajtur reciprocitetin me tabelat, por do të tentojë ta fshehtë faktin se nga një çështje krejt teknike, ka shkaktuar një problem të sigurisë nacionale dhe një problem politik të rëndë për Kosovën. Kurti dhe qeveria e tij do të tentojnë ta fshehin edhe faktin që policia speciale largohet me detyrim nga terreni dhe, fatkeqësisht, largimi i saj barazohet me largimin e bandave serbe që kishin bllokuar rrugët. Kurti do të tentojë ta fshehtë faktin se kthimi i KFOR-it është kthim prapa i sigurisë dhe i institucioneve të Kosovës. Propaganda e fuqishme e qeverisë dhe e LV-së, si dhe injoranca e masave, mund ta ndihmojnë që t'i fshehtë këto dështime të rënda.

4. Qeveria e Serbisë do të krekoset se e ka shpëtuar popullin serb në Kosovë nga pogromi. Vuçiqi dhe qeveria serbe do të manipulojnë me ndjenjat e serbëve deri në absurditet. Do të krekosen se kanë guxuar të aktivizojnë tanke e avionë, por do ta fshehin faktin se nuk ka guxuar dhe nuk guxojnë fare t'i afrojnë në kufirin e Kosovës, gjë që ia ndalon Marrëveshja Tekniko-Ushtarake

me NATO-n. Vuçiqi dhe qeveria serbe do të tentojnë të thotë se e kanë ruajtur paqen, ndonëse u pa qartë që ai është luftënxitës i tmerrshëm, nxënës besnik i Sheshelit dhe Millosheviqit. Në fakt, ai është kriminel lufte që nga vitet '90.


5. E sigurt është që Vuçiqi dhe Kurti do të jenë humbës në sytë e ShBA-së, NATO-s dhe BE-së. Kurti do të mbahet përgjegjës që ka dërguar në një mision të panevojshëm e të rrezikshëm policinë speciale, duke rrezikuar të shkaktohen incidente të rënda me serbët lokalë. Vuçiqi do të mbahet përgjegjës për lojërat me armë në kufi, duke provokuar NATO-n. Vizita e ambasadorit rus në afërsi të kufirit, nuk do të kalojë pa u evidencuar si vasaliteti i Serbisë ndaj Rusisë.

6. Fitues morale dhe reale nga kjo krizë janë KFOR-i, ShBA-ja, BE-ja. Ata e shmangën krizën dhe e gjetën një formulë për një marrëveshje të përkohshme, e cila e rifuqizoi KFOR-in në terren dhe ndërmjetësinë e BE-së dhe SHBA-së në Bruksel.

7. Fitues moral në këtë krizë është edhe opozita, PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja, të cilat në këtë rast konkret dëshmuar se interesin shtetëror e kanë mbi interesin partiak. Po ashtu, fitues është edhe Edi Rama, i cili vizitën e tij në Kosovë e shfrytëzoi në mënyrë maestrale, për vetveten.

NDËRKOHË QË REFUZOJMË PROJEKTIN AMERIKAN TË GAZIT, DY FJALË PËR MARRËVESHJEN E RADHËS PËR TABELA VETURASH

NUK BARAZOHET KRENARIA JONË ME NJË GRUSHT BANDITËSH SERBË



Nga: Muhamet MAVRAJ

Tash bërtasim kot në veshët e stanit, nuk na dhezi mendimi kundërshtues.

Vendimi ynë shtetëror u zhbë. Marrëveshja e tretë për tabelat u arrit në Bruksel. Para verës së ardhshme bëhet e katërta (pra pas zgjedhjeve serbe). Serbia po e zvarrit kaq lehtë kohën e Kosovës! Nuk flitet gjë për palën në rast se e shkelë marrëveshjen. Nuk ka detyrime, nuk ka shtrëngime. Askush nuk e garanton zbatimin korrekt as për këtë, as për të ardhmen, si për të shkuarat: mbetet çështje bese. Këso reciprociteti nuk po e zbulojmë për herë të parë. Marrëveshja e sotme:

- Krenaria jonë, Policia Speciale, që e kurthuam me gjithë makineritë andej bllokadës, trajtohet barazisht me bandën bllokuese në rrugë:

Asnjëra palë as një minutë para tjetrës nuk tërhiqet nga pozicionet, por njëkohësisht. Tetë orë.

- KFOR-i (për karburant retorik serb dhe elektoral për rezolutën 1244), sado që po thuhet përkohësisht, kthehet në fuqinë para pavarësisë për sigurinë që ishte kompetencë e jona policore.

Vendimi ynë i drejtë dhe i pakontestueshëm nga Perëndimi për tabelat duhej zbatuar hap pas hapi, çdo ditë ngapak, pak këtu, pak atje, pa tërheqje, qetësisht e këmbëngulshëm, dhe mbi të gjitha pa spektakël që i jep rol palës tjetër, pa mobilizimin e frymës çetnike. Ishte karburant propagandistik në kontekst elektoral e penal të të dy qeverive. U nis me nijet interesngusht dhe nuk do të

sillte krenari të gjerë kombëtare! Për të ardhmen: bishtin e gjatë mbrapa.

- Serbia mund të tallet duke lëshuar targa për komunat tona, meqenëse vetëm simboli shtetëror mbulohet;

- Praktika e bllokadave në rrugë është tashme norme e ngurosur. Reciprocitetet tjera nuk bëhen pa palën e kamionëve bllokues.

- Dialogu me serbet lokale nuk vlen pesë para, ishte farsë!

- Negociata Po, Vetëvendosje Jo!

- Kosova temë dhe jo palë!

Çfarë makiavelizmi shembullor në praktikë!

Jo dorëheqje, Jo shkarkime pa u ngi mirë! Hajt zekë hajt!

PS:
T'u kthehen paratë preshevarëve dhe shqiptarëve tjerë të Kosovës Lindore për tabelat provuese!

24 vjet nga protesta studentore e 1 tetorit të vitit 1997

Sot, më 1 tetor, mbushen 24 vjet nga protesta e Lëvizjes Studentore e vitit 1997. Në 24-vjetorin e kësaj proteste profesorët universitarë të historisë, Muhamet Mala dhe Ibrahim Gashi, kanë thënë se ndikimet e kësaj ngjarjeje ishin të mëdha në rrjedhat e proceseve të mëvonshme politike. Ata kanë deklaruar se kjo lëvizje solli një kthesë historike në procesin e lëvizjes për çlirimin e Kosovës

“Epoka e re”

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Sot (e premte) mbushen 24 vjet nga protesta e Lëvizjes Studentore e vitit 1997. Ishte Lëvizja Studentore e atëhershme që organizoi protestat të cilat u organizuan për ta kundërshtuar pushtimin e Kosovës nga Serbia dhe kthimin e studentëve në objektet universitare, nga të cilat studentët ishin dëbuar nga regjimi i kasapit Slobodan Millosheviqi në fillim të viteve '90. Përpos masave të dhunshëm që regjimi kishte vendosur vite më parë në universitet, dëboi studentët dhe profesorët nga universiteti dhe imponoi planprogramin serb për mësim. Kjo protestë konsiderohet si një ndër aktet më të rëndësishme të asaj kohe. Për ta shpërndarë protestën paqësore, policia serbe përdori dhunë ndaj studentëve

dhe profesorëve.

Në ballë të kësaj proteste ishin liderët e Lëvizjes Studentore, Muahmet Mavraj, Bujar Dugolli, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, së bashku me rektorin e atëhershëm të Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci. Pas tyre, në këtë protestë ishin edhe mijëra studentë.

Lëvizja Studentore e '97-s është vlerësuar krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare të Kosovës nga historianët e njohur të Kosovës.

Në 24-vjetorin e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997, profesorët universitarë të historisë, Muhamet Mala dhe Ibrahim Gashi, kanë thënë për “Epokën e re” se ndikimet e kësaj ngjarjeje ishin të mëdha në rrjedhat e proceseve të mëvonshme politike. Ata kanë deklaruar se kjo lëvizje solli një kthesë historike në procesin e lëvizjes për çlirimin e Kosovës.

Profesor Muhamet Mala ka vlerësuar se Lëvizja Studentore e



'97-s ishte krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare. “Në përvjetorin e 24-t të Lëvizjes Studentore, mendoj se kjo lëvizje ka qenë një krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare e cila kishte filluar

shumë më herët”, ka thënë Mala. Ai ka vlerësuar se kjo lëvizje ishte revolucionare në kuptimin pozitiv të fjalës. “Kjo lëvizje ishte revolucionare në kuptimin pozitiv të fjalës, mirëpo i mungonte edhe

krahu intelektual. E krahu intelektual është pikërisht ajo forca lëvizëse e cila e ka çuar këtë proces përpara”, ka thënë ai.

Sipas historianit Mala, ndikimi i kësaj ngjarjeje në proceset e mëvonshme ishte i madh. “Mendoj se Lëvizja Studentore i ka dhënë shpirt edhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u ka dhënë shpirt të gjitha proceseve të tjera historike në kuptimin pozitiv të fjalës. Pra, sistemi i funksionimit të lëvizjes çlirimtare në Kosovë ka qenë komplementar dhe plotësues. Në njërin anë, një krahu i fortë ushtarak dhe, në krahun tjetër, ai intelektual. Pa bashkimin e këtyre dy elementeve nuk kemi mundur të arrijmë aty ku jemi sot. E pikërisht elementi i Lëvizjes Studentore ka qenë ai që e ka zgjuar dhe i ka dhënë një impuls kësaj lëvizje”, ka deklaruar profesori Mala. Sipas tij, Lëvizja Studentore e '97-s solli ide dhe ideale të reja në rrugën e çlirimit të Kosovës.

Edhe profesori tjetër universitar i historisë, Ibrahim Gashi, ka folur për “Epokën e re” për ndikimet e kësaj ngjarjeje. Ai ka deklaruar se protesta e 1 tetorit e vitit 1997 ka shënuar fundin e lëvizjes paqësore. “Protesta studentore e vitit 1997 është një ngjarje e shënuar në historinë më të re të Kosovës. Kjo dhe këto protesta kanë lëvizur procesin e lëvizjes për çlirim dhe pavarësi të vendit një hap më tutje. E them kështu sepse këto protesta shumica e autorëve përëndimorë i konsiderojnë si fundin e lëvizjes së rezistencës paqësore”, ka thënë Gashi.

Ai ka deklaruar se pas këtyre protestave fillon të dalë në plan të parë lëvizja aktive, lëvizja e armatosur për çlirimin e Kosovës. “Në fakt, autori Hovert Clark protestën e 1 tetorit e quan si fundin e veprimit joviolent. Sipas tij, protesta shpërfaq në njëfarë mënyre dështimet e lëvizjes paqësore për ta çuar përpara çështjen e Kosovës. Pra, pas këtyre protestave fillon të dalë në plan të parë lëvizja aktive, pra lëvizja e armatosur për çlirimin e Kosovës”, ka thënë Gashi.

Edhe protagonistët e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 e kanë vlerësuar këtë ngjarje shumë të rëndësishme në historinë më të re të Kosovës. Në përvjetorët e tjerë ata kanë vlerësuar se Lëvizja Studentore ka arritur qëllimin, duke ngritur një popull të tërë të pasivizuar e të pashpresë.



Veprimtari Sali Bislimi takon presidentin e Zvicrës

BERN, 30 SHTATOR (ER) - Drejtori i organizatës joqeveritare “Zëri Perëndimor i Kosovës”, Sali Bislimi, që jeton dhe vepron në Zvicër, i cili vazhdimisht ka dhënë kontribut për Kosovën, ka takuar të enjten presidentin e Zvicrës, Guy Parmelin. Ai përmes një njoftimi në llogarinë e vet në “Facebook”

ka njoftuar për këtë takim dhe për bisedën që ka pasur me presidentin zviceran. “Sot pata kënaqësinë dhe nderin që të takohem në Pallatin Federal me presidentin e Zvicrës, z. Guy Parmelin, bashkëshorten e tij Carolinen dhe parlamentarën, mikun tim të nderuar z. Jean-Pierre Grin.

Bëra një rezymë për gjendjen në Kosovë, përafrimin e dy vendeve tona, integrimin dhe vlerat përëndimore të vendit tonë. Kërkova që Zvicra të garantojë sigurinë e presidentit Thaçi në rast të lirimit të tij me kusht nga Dhomat e Specializuara në Hagë”, ka thënë Bislimi.





KOSOVA DHE SERBIA KANË ARRITUR MARRËVESHJE PËR TARGAT NË BRUKSEL

Pajtohen për reciprocitet të targave dhe për tërheqjen e Njësisë Speciale nga veriu

Pas dy ditësh negociata, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për shtensionimin e situatës në veri. Marrëveshja parasheh reciprocitet në targa në mes të dy shteteve, duke ua mbuluar simbolet shtetërore. Sipas dokumentit trepikësh, njësitet speciale policore të vendosura në pikëkalimet kufitare duhet të largohen bashkë me barrikatadat. Qeveria e ka cilësuar si fitore këtë marrëveshje, ndërsa opozita e ka kritikuar, duke thënë se qeveria ka barazuar Policinë e Kosovës me barrikaduesit dhe ka dorëzuar sovranitetin te një palë e tretë. ShBA-ja dhe BE-ja e kanë mirëpritur marrëveshjen

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Kosova dhe Serbia kanë arritur të enjten marrëveshje për targa në Bruksel. Marrëveshja e përbërë prej tri pikave parasheh që nga 4 tetori të zbatohet reciprociteti në targa, duke mbuluar simbolet shtetërore deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme.

Pika e parë e marrëveshjes flet për shtensionimin e situatës në veri dhe për largimin njësisve speciale të Policisë së Kosovës

të vendosura në pikat kufitare bashkë me barrikatadat. "Njësitet speciale policore të vendosura në pikëkalimet e përbashkëta kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak do të largohen bashkë me barrikatadat, duke nisur nga 2 tetori, ora 08:00, deri në orën 16:00 të asaj dite. Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, do të angazhohet në këto dy pika në Jarinjë dhe Bërnjak, para nisjes së tërheqjes të zyrtarëve policorë dhe barrikadave, dhe do të mbetet aty për dy javë për ta garantuar sigurinë", thuhet në pikën e parë të

marrëveshjes.

Pika e dytë flet për reciprocitetin në targa. "Nga 4 tetori do të nisë së zbatuari përkohësisht regjimi i letrave ngjitëse në vend të heqjes së targave të makinave të regjistruara në Kosovë dhe Serbi deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme", thuhet në pikën e dytë.

Kurse në pikën e tretë të dokumentit parashihet formimi i grupeve punuese për gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme. "Më 21 tetor do ta nisë punën një ekip i përbërë

nga zyrtarë të Bashkimit Evropian, Prishtinës dhe Beogradit për të gjetur një zgjidhje të përhershme. Brenda gjashtë muajve, prej nisjes së takimit të parë, i ashtuquajturit grup punues do t'i prezantojë gjetjet për një zgjidhje të përhershme në formatin e dialogut të nivelit të lartë", është thënë në pikën e tretë të marrëveshjes.

Emisari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka falënderuar palët për konstruktivitetin e treguar. "Ne kemi një marrëveshje! Pas dy ditësh negociatash intensive, një marrëveshje për depërshkallëzimin dhe rrugën përpara sapo është arritur. Falënderoj Besnik Bislimin dhe Petar Petkoviçin për gatishmërinë e tyre për të negociuar dhe pajtuar për të mirën e njerëzve", ka shkruar Lajçaku në llogarinë e vet në

"Twitter".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, arritjen e marrëveshjes e ka konsideruar si fitore të Kosovës. Ai ka deklaruar se Serbia do të nisë të mësohet me reciprocitet. "Reciprociteti i targave të automjeteve është vendosur. Meqë targa të Republikës së Kosovës në Serbi do t'u mbulohej simboli shtetëror, të gjitha targa të Serbisë pa dallim do t'u mbulohej, po ashtu, simboli i tyre në territorin e shtetit tonë. Njësia Speciale e Policisë së Kosovës ka shkuar në Jarinjë dhe Bërnjak më 20 shtator për t'i mbrojtur vendkalimet dhe policinë kufitare nga bllokuesit e rrugëve dhe qarkullimi i lirë. Meqë ata do të largohen, njësia jonë speciale nuk ka pse qëndron atje, dhe mbetet gjithnjë e gatshme për ndërhyrje në çfarëdo cenimi të njëjtë apo të ngjashëm në të ardhmen", ka shkruar Kurti në



përfaqësuesve tanë. Natyrisht që nuk ju plotësuan ato dhe dje u zhvilluan bisedimet në Bruksel. Tash fillon epoka kur Serbia nis e mësohet me reciprocitet”, ka shkruar Kurti. Edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është shprehur i kënaqur me marrëveshjen. “Mendoj se kemi arritur një lloj zgjidhjeje kompromisi, me të cilën personalisht jam shumë i kënaqur”, ka deklaruar Vuçiq. Sipas tij, marrëveshja i ka “anët e mira dhe të këqija”. Ai ka deklaruar se për Serbinë është e rëndësishme që Njësia Speciale e Policisë së Kosovës të tërhiqet nga veriu i Kosovës.

BE-ja dhe ShBA-ja mirëpresin marrëveshjen

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë mirëpritur arritjen e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. Shefi i diplomacisë i BE-së, Josep Borrell, ka deklaruar se pas kësaj marrëveshjeje, Kosova dhe Serbia duhet t'i rikthehen dialogut për normalizimin e raporteve. “E mirëpres arritjen e marrëveshjes mes kryenegociatorëve të Kosovës e Serbisë, të lehtësuar nga emisari Miroslav Lajçak, për t'i zgjidhur tensionet në veri të Kosovës. Si Kosova ashtu edhe Serbia duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialog për të bërë përparim të shpejtë drejt normalizimit të marrëdhënieve”, ka shkruar Borrell në llogarinë e vet në

“Twitter”.

Kurse i ngarkuari me punë në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Nicholas J. Giacobbe, ka deklaruar se arritja e kësaj marrëveshjeje dëshmon se riangazhimi në dialog sjell përfitime për qytetarët e Kosovës dhe Serbisë. “Lajm i mirë nga Brukseli - një shembull sesi riangazhimi në dialog mund të ketë përfitime reale dhe të qëndrueshme për kosovarët dhe serbët. Faleminderit i dërguari Lajçak për ndërmjetësimin dhe partnerëve në Kosovë dhe Serbi për vullnetin dhe gatishmërinë e tyre për të negociuar”, ka shkruar ai në “Twitter”.

Opozita e kritikon marrëveshjen

Pas arritjes së marrëveshjes për targa, kanë reaguar edhe subjektet politike opozitare. Ato e kanë përkrahur vendosjen e reciprocitetit për targa, por kanë kundërshtuar barazimin e Policisë së Kosovës me barrikaduesit.

Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se marrëveshja e arritur në Bruksel është e njëjta me atë të vitit 2016, me disa hapa prapa. “Marrëveshja e njëjtë, që tashmë ishte arritur më 2016, me disa hapa prapa. KFOR-i nuk është reagues i parë. Dhe, pjesa më shqetësuese, kjo marrëveshje i barazon forcat e sundimit të ligjit në Kosovë me huliganët që vendosin barrikada”, ka shkruar Çitaku në llogarinë e saj në “Twitter”.

Edhe Lidhja Demokratike e

Kosovës ka kritikuar marrëveshjen në pika të njëjta. “Në vend të shtrimit të sovranitetit e ligjshmërisë, sot Qeveria e Kosovës u tërhoq dhe dorëzoi këtë sovranitet te një palë e tretë. Për më tepër, këtë tërheqje e bëri në pajtim me Serbinë që nuk na njeh. Ky vend fqinj, Serbia pra, nga sot jep pëlqim ose jo mbi organizimin e ligjshëm të territorit të Kosovës. Pra pajtimi i Serbisë, se si rregullohet ligjshmëria në Kosovë, ku qëndrojnë Njësitë Policore e kur e në çfarë afati largohen ato, është prapakthim i rëndë. Mbi të gjitha, është precedent i rrezikshëm për të ardhmen; nga tani, sa herë që forcat e rendit shkojnë në veri për të vënë ligjshmëri, barrikadat ngrihen e Kosova duhet të negociojë me Serbinë për largimin e tyre”, është thënë në reagimin e LDK-së. Sipas LDK-së, kjo marrëveshje është ajo e vitit 2016. “LDK-ja, po ashtu, kundërshton fuqishëm legjitimitetin e tabelave të qyteteve të Kosovës të lëshuara në Serbi. Vazhdimi i përdorimit të tyre është, po ashtu, prapakthim. Asnjë tiketë ngjitëse, asnjë masë tjetër, nuk mbulon gabimin e rëndë që Qeveria e Kosovës ka bërë sot. LDK-ja vlerëson se sovraniteti i dorëzuar nuk mund të jetë sovranitet i ushtruar. Marrëveshja e sotme është marrëveshja e vitit 2016, e quajtur dikur ‘marrëveshje e turpit’ nga po këta që e riaktivizuan sot, por e degraduar, meqë rendin dhe ligjin në veri më nuk mund ta ushtrojnë institucionet e Republikës së Kosovës pa i

lejuar Serbia”, ka vlerësuar LDK-ja.

Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta publikojë tekstin integral të marrëveshjes së arritur me Serbinë për targa. “Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që menjëherë ta publikojë tekstin integral të marrëveshjes për targa. Nëse është e vërtetë se qeveria ka pranuar ta trajtojë ndryshe veriu nga pjesa tjetër e Kosovës, kjo për ne është krejtësisht e papranueshme dhe e dënueshme. Karakteri unitar i shtetit nuk mund të preket. Po ashtu, jemi të indinjuar me barazimin që i është bërë Policisë Speciale të Kosovës me grupet kriminale që kanë bllokuar rrugët në veri. Njëjtësimi i tërheqjes së grupeve kriminale me tërheqjen e Njësive Speciale të Policisë së Kosovës është ofendim dhe goditje për sovranitetin e Kosovës!”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”. Më 20 shtator Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që automjete nga Serbia, me të hyrë në Kosovë, t'i ndërrojnë ose mbulojnë targa e tyre dhe të marrin regjistrim të përkohshëm të Kosovës. Me këtë vendim, Qeveria e Kosovës ka thënë se ka vendosur masën e reciprocitetit për targa e Serbisë, pasi një gjë të ngjashme Serbia e ka aplikuar për veturat nga Kosova për më shumë se dhjetë vjet. Ndaj këtij vendimi kanë reaguar serbët lokalë, duke bllokuar rrugët që dërgojnë në dy vendkalimet kufitare në veri të Kosovës, Jarinjë dhe Bërnjak.

profilin e vet në “Facebook”, duke shtuar se policia kufitare do të vazhdojë të qëndrojë në kufi. “Natyrisht, policia jonë kufitare në vijim do të zbatojë reciprocitetin e targave. KFOR-i do të qëndrojë aty, rreth dy javë, që gjithçka të jetë e sigurt. Në javën e shkuar, presidenti i Serbisë vuri katër kushte për takimin në Bruksel të

Katër viktimat dhe mbi 40 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Në Kosovë u konfirmuan të enjten edhe katër viktimat nga Covid-19. Në raportin ditor të Ministrisë së Shëndetësisë është bërë me dije edhe për 45 raste të reja të të infektuarve me Covid-19.

Rastet pozitive rezultuan pas testimit të 3 380 mostrave.

Në 24 orët e fundit, thuhet në raport, u shëruan 298 pacientë, ndërsa raste aktive mbeten 2 928.


Fushata e vaksinimit kundër Covidit në Kosovë ka nisur në fund të marsit.

Deri të enjten janë dhënë mbi 1.3 milion vaksina. Mbi 530

000 qytetarë janë vaksinuar plotësisht.

Aktualisht në Kosovë janë në fuqi masat që kërkojnë dëshmi të vaksinimit ose test negativ të koronavirusit për të hyrë në objekte të gastronomisë, por edhe në institucionet publike dhe private që kanë punë me palë.

Më 27 shtator ka filluar mësimi në shkollë, ndërsa aktivitetet sportive në ambientet e mbyllura mund të zhvillohen me 10 për qind të kapacitetit. I njëjti rregull do të vlejë edhe për organizimet kulturore. Në ambientet e hapura mund të zhvillohen aktivitetet me 30 për qind të kapacitetit me të njëjtin rregull të pjesëmarrjes.



Gjykatat kanë zgjidhur një numër të vogël të rasteve të krimit të organizuar



Pandemia Covid-19 ka kufizuar në masë të ndjeshme punën e institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Kështu është bërë me dije të enjten në paraqitjen e analizës: “Trajtimi i rasteve të krimit të organizuar nga ana e prokurorisë dhe gjykatave për periudhën qershor 2019 - gusht 2021”. Po në këtë analizë është theksuar se gjykatat kanë zgjidhur një numër të vogël të rasteve të krimit të organizuar

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - “Drejtësia sot”, platformë e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), ka organizuar të enjten konferencë për media, në të cilën janë paraqitur të gjeturat e analizës: “Trajtimi i rasteve të krimit të organizuar nga ana e prokurorisë dhe gjykatave për periudhën qershor 2019 - gusht 2021”.

“Drejtësia sot” përmes këtij hulumtimi ka analizuar bazën ligjore për ndjekjen e veprës penale të krimit të organizuar, pastaj të dhënat statistikore të gjykatave dhe prokurorive për luftimin e kësaj dukurie, e deri te sfidat e këtyre institucioneve për trajtimin e këtyre lëndëve.

Gjatë analizimit të tyre vëmendje e veçantë u është kushtuar efikasitetit të institucioneve të drejtësisë për zhvillimin e hetimeve dhe gjykimin e rasteve të krimit të organizuar, pastaj efektin e pandemisë Covid-19 në procedimin e rasteve të tilla penale e deri te mangësitë ligjore

të aktakuzave dhe aktgjyqimeve të gjykatave.

Nga analizimi i këtyre aktakuzave “Drejtësia sot” ka gjetur se gjatë periudhës qershor 2019 - gusht 2021, Prokuroria Speciale (PSRK) ka ngritur një numër të vogël të aktakuzave për krim të organizuar. Në gjykatë janë dorëzuar vetëm dhjetë aktakuzave për këtë lloj të veprës penale.

“Drejtësia sot”, gjithashtu, ka vërejtur se numri më i madh i aktakuzave të ngritura nga PSRK-ja është ngritur për veprat penale që lidhen me narkotikë. Pra gjatë periudhës raportuese, PSRK-ja luftën e saj ndaj krimit të organizuar e ka fokusuar më shumë në lëndët narkotike dhe veprat penale që lidhen me këto lëndë.

“Drejtësia sot”, duke analizuar numrin e rasteve të trashëguara, të pranuar dhe ato në punë në gjykatat e Kosovës, ka vërejtur se gjykatat kanë arritur të zgjidhin një numër tejet të vogël të rasteve të krimit të organizuar. Përgjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019 (janar - qershor), sipas

të dhënave zyrtare dhe ato të monitorimit të “Drejtësia sot”, janë zgjidhur vetëm pesë lëndë, prej gjithsej 60 lëndëve të cilat kanë qenë në punë. “Po ashtu, gjykatat nuk kanë treguar efikasitet të kënaqshëm as përgjatë vitit 2020, për faktin se nga 59 lëndë të trashëguara dhe 6 të pranuar, kanë arritur të zgjidhin vetëm 5 raste të krimit të organizuar. Ndërsa sipas të dhënave zyrtare të pranuar, në vitin 2021 është përfunduar vetëm një lëndë në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kurse gjykatat e tjera që kanë në punë raste të tilla nuk kanë arritur të zgjidhin asnjë prej tyre”, thuhet në këtë analizë.

Më tej theksohet se gjatë monitorimit është vërejtur se të gjitha gjykatat, në veçanti Gjykata Themelore në Prishtinë, pavarësisht prej numrit më të madh të rasteve, nuk ka caktuar seanca në formë konsistente ndaj personave që janë duke u gjykuar për këto vepra penale në mënyrë që lëndët e tyre të përfundojnë brenda një kohe të

arsyeshme.

Në bazë të të dhënave të monitorimit të “Drejtësia sot”, për periudhën raportuese qershor 2019- dhjetor 2020, nga 27 raste të krimit të organizuar që kanë qenë në punë janë mbajtur vetëm 80 seanca. Ndërsa përgjatë vitit 2021 “Drejtësia sot” ka raportuar për gjithsej 79 seanca, prej të cilave 55 janë proceduar me rregull, ndërsa 24 seanca kanë dështuar të mbahen.

“Drejtësia sot” ka ngritur shqetësimin e saj për mosmbajtjen e seancave për rastet e krimit të organizuar, veçanërisht në disa raste për të cilat aktakuzat janë ngritur para pesë vjetëve apo më shumë. Sipas vlerësimit të “Drejtësia sot”, ky veprim është tejet shqetësues pasi shpërfaq neglizhencën e kësaj gjykatë në luftimin dhe sanksionimin e krimit të organizuar. “‘Drejtësia sot’ përgjatë monitorimit sistematik të sistemit prokurorial dhe gjyqësor ka gjetur se Gjykata Themelore në Mitrovicë ka një mungesë pothuajse absolute të efikasitetit në zgjidhjen e rasteve të krimit të organizuar. Përkundër faktit se kjo gjykatë në këtë periudhë ka pasur në punë 16 lëndë të krimit të organizuar, ka përfunduar vetëm një të tillë. Në këtë gjykatë gjatë periudhës raportuese janë caktuar vetëm tetë seanca, prej të cilave dy janë mbajtur, tri janë anuluar paraprakisht dhe tri kanë

dështuar”, theksohet në këtë analizë. Më tutje, bëhet me dije se është vërejtur se pandemia Covid-19 ka kufizuar në masë të ndjeshme punën e institucioneve të drejtësisë, në mesin e të cilave edhe të gjykatave.

Nga të gjeturat e kësaj analize, “Drejtësia sot” rekomandon që Prokuroria Speciale me rastin e ngritjes së aktakuzave për krim të organizuar, ato t’i hartojë në mënyrën profesionale; “Drejtësia sot” fton gjykatat themelore në Republikën e Kosovës që t’i caktojnë seancat gjyqësore për rastet e krimit të organizuar duke zbatuar udhëzimet dhe rekomandimet e KGJK-së për mbarëvajtjen e procedurave gjyqësore në kohë të pandemisë Covid-19; “Drejtësia sot” fton gjykatat themelore në Republikën e Kosovës, respektivisht gjyqtarët që gjykojnë rastet e krimit të organizuar, që të zbatojnë Udhëzuesin për Politika Ndëshkimore të nxjerra nga Gjykata Supreme e Kosovës, në mënyrë që të vlerësohen drejt të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në matjen e dënimit për këto raste; dhe fton KPK-në dhe KGJK-në që në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë të organizojnë trajnime për ngritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe gjyqtarëve që trajtojnë rastet e krimit të organizuar.

Kthehen në Kosovë mbetjet mortore të shtatë viktimave të masakrës së Rezallës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Mbetjet mortore të shtatë shqiptarëve të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë u kthyen të enjten nga Serbia.

Mbetjet u kthyen përmes pikës kufitare të Merdares.

Viktimat ishin vrarë në fshatin

Rezallë të komunës së Skenderajt më 1999.

Në pritje të tyre dolën familjarë dhe qytetarë të tjerë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili, po ashtu, ishte në Merdar, tha se masakra e Rezallës “është një nga dëshmitë e gjenocidit të Serbisë në Kosovë”.

Kryetari i Skenderajt, Bekim



Jashari, u ka shprehur ngushëllime familjeve që kanë pritur eshtrat e familjarëve të tyre të zhdukurve në masakrën e Rezallës.

Jashari ka thënë se ndaj Serbisë faktori ndërkombëtar duhet të ushtrojë presion më të madh pasi që ajo ende mban peng eshtrat e personave të zhdukur në Kosovë gjatë luftës së fundit.

“Duhet të shtohet presioni ndërkombëtar mbi Serbinë që ende mban peng eshtrat e më të dashurve tanë. Ajo ende nuk ka dhënë përgjegjësi ndërkombëtare për gjenocidin e bërë në Kosovë dhe ende shpreh pretendime territoriale në

shtetin tonë. Këto pamje, sot para nesh, duhet të trokasin në ndërgjegjen e secilit prej nesh, në veçanti të politikanëve tanë që të bashkohen në të mirë të shteti”, ka thënë ai. Ai ka theksuar se pamja e arkivoleve sot duhet të prekë në ndërgjegjen e politikanëve në vend, të cilët duhet të bashkohet për të mirën e shtetit.

Në këtë masakër forcat serbe vranë rreth 100 shqiptarë, dhjetëra trupa të të cilëve u zhdukën. Mbetjet mortore të shtatë viktimave u gjetën në një varr masiv në Kizhevak të Serbisë. Disa mbetje të dy prej tyre u gjetën më herët në

Rudnicë dhe iu bashkuan pjesëve të tjera të gjetura në Kizhevak.

Gërmimet në Kizhevak u kryen në fund të vitit të kaluar dhe këtë vit, ndërsa në Rudnicë në vitin 2014.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në vitin 1999, rreth 6 500 persona kanë qenë të zhdukur. Që nga ajo kohë janë kryer disa zhvarime në varreza masive në Kosovë dhe Serbi dhe deri më tash janë gjetur rreth 70 për qind e të zhdukurve. Sipas autoriteteve në Kosovë, të pagjetur vazhdojnë të jenë edhe rreth 1 600 persona, kryesisht shqiptarë.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë, memorandum bashkëpunimi

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

TIRANË, 30 SHTATOR - Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, i udhëhequr nga kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, po qëndron në vizitë zyrtare dyditore në Shqipëri.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, kryetarja Caka-Nimani dhe homologa e saj shqiptare, Vitore Tusha, nënshkruan memorandum

bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, me qëllim të vazhimit të bashkëpunimit të dy gjykatave për një periudhë të re pesëvjeçare në fushat me interes të ndërsjellë.

Memorandumi i bashkëpunimit, ndër të tjera, parashihet zhvillimin e programeve të bashkëpunimit dypalësh me qëllim të përvetësimit të praktikave më të mira evropiane të së drejtës kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, forcimin e kapaciteteve

profesionale të gjyqtarëve dhe të stafit mbështetës, rritjen e cilësisë së vendimeve dhe përmirësimin e komunikimit me publikun.

Me përkrahjen e fondacionit gjerman “Hans Siedel Stiftung”, në vazhdim të vizitës në Shqipëri, gjyqtarët e të dy gjykatave kushtetuese të enjten morën pjesë në tryezën e rumbullakët me temë: “Mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore - praktikave respektive sipas jurisprudencës kushtetuese”.

Konjufca takon përfaqësuesit e misionit vëzhgues të zgjedhjeve ENEMO-s

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim përfaqësuesit e misionit vëzhgues të Rrjetit Evropian të Organizatave Monitoruese të

zgjedhjeve (ENEMO), Pierre Peytier dhe Elene Nizharazde. Në takim u diskutua për zgjedhjet lokale që pritet të mbahen më 17 tetor 2021, me çrast përfaqësuesit e ENEMO-s

e njoftuan kryetarin e Kuvendit lidhur me angazhimin, përbërjen, qëllimin dhe metodologjinë e këtij misioni vëzhgues. Konjufca ka shprehur mirënjohje për

punën e ENEMO-s, duke ofruar njëherësh mbështetje, bashkëpunim dhe bashkërendim institucional për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të 17 tetorit.



Besnik Pula zgjedhet kryetar i grupit punues për formimin e Fondit Sovran

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Komisioni Ekzekutiv për propozimin dhe hartimin e parimeve themelore, si parakusht për themelimin e Fondit Sovran të Republikës së Kosovës, ka mbajtur të enjten mbledhjen e parë. Në mbledhje u miratua grupi punues i përbërë nga anëtarët: Arta Hoxha, eksperte e auditimit bankar, anëtare e Bordit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Edison Jakurti, doktorant i ekonomisë, ekspert i çështjeve të ekonomisë së brendshme, Emanuel Bajra, ekspert i industrisë ndërkombëtare financiare, dhe Tea Blakaj Hoxha, këshilltare ligjore e kryeministrit.

Kryetar i grupit punues u zgjodh Besnik Pula, profesor në Universitetin Virginia Tech në ShBA, njëkohësisht këshilltar i kryeministrit Kurti për marrëdhënie ekonomike ndërkombëtare, i cili bëri një prezantim të shkurtër përpara komisionit.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se në këtë mbledhje po nis një nga reformat më të mëdha ekonomike të vendit tonë që nga pavarësia. Themelimi i Fondit Sovran do të japë një shpresë të re për zhvillim ekonomik në Kosovë, pas një modeli ekonomik, i cili që nga paslufta nuk solli ndryshimet aq të pritura dhe shpresat për vendin që pat populli i Kosovës, tha ai. “Sot jemi këtu për të treguar se ka alternativë ndaj rrugës së ndjekur deri më tani. Një ndër to është ajo që ne besojmë: shteti zhvillimor. Shteti i cili në ekonomi nuk është as regjisor e as spektator, por bashkëshkenarist dhe aktor. Në funksion të konkretizimit të shtetit zhvillimor e kemi menduar, premtuar dhe tani do ta realizojmë njërin ndër institucionet e tij - Fondin Sovran të Republikës së Kosovës”, ka thënë kryeministri Kurti.

Ai ka thënë se ndërmarrjeve tona nuk u duhet vetëm ndërrimi i kahut të përgjithshëm nga minusi drejt zeros, gjë që duhet ta bëjnë



bordet e reja profesionale. Atyre, siç tha ai, duhet edhe t'u rritet vlera përmes menaxhimit më të mirë ditor, i cili i ndërron bilancet financiare vjetore nga deficitin në surplus. Kështu ato, sipas

kryeministrit Kurti, nuk do të shihen më si barrë për buxhetin e republikës, por do të shndërrohen në krahë të fortë të zhvillimit ekonomik në vend. “Këtë qëllim parësor do ta ketë Fondi Sovran. Ai

duhet të kujdeset për menaxhimin e performancës financiare të aseteve strategjike. Kjo nënkupton ngritje të performancës, rritje të vlerës dhe rritje të kthimit në investime”, ka thënë Kurti.

Banka Botërore përkrah reformimin e skemave të ndihmës sociale në Kosovë



Prishtinë, 30 shtator (ER) - Banka Botërore ka njoftuar se ka miratuar Projektin e Reformës së Sistemit të Ndihmës Sociale për Kosovën, i cili, sipas saj, synon ta përmirësojë paanshmërinë dhe përshtatshmërinë e programeve të ndihmës dhe mbrojtjes sociale. Sipas BB-së, mbështetja financiare për këtë projekt është 47 milionë euro kredi nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) me afat të shlyerjes për 30 vjet. “Kosova e ndan një pjesë të rëndësishme të buxhetit të saj për programet e mbrojtjes sociale, por efikasiteti dhe ndikimet rishpërndarëse të këtyre programeve mund të përmirësohen, veçanërisht në kontekstin e Covid-19. Banka Botërore i mbështet përpjekjet e

Kosovës për ta reformuar Skemën e Ndihmës Sociale, në mënyrë që ajo të jetë më e paanshme, më efikase dhe më fleksibile, dhe kështu më e pajisur për të reaguar ndaj krizave në të ardhmen”, është shprehur Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut. Konkretisht, ky projekt do ta mbështesë Qeverinë e Kosovës për reformimin e dizajnit të Skemës së Ndihmës Sociale (SNS), investimin në sistemet e ofrimit të SNS-së dhe rritjen e vlerës së përfitimeve nga SNS-ja, për t'i zbutur efektet ekonomike të pandemisë Covid-19. Këtë projekt do ta zbatojë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për një periudhë pesëvjeçare.

Ndërtimtaria dhe tregtia, me rritjen më të madhe gjatë tremujorit të dytë 2021

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Tregtia dhe ndërtimtaria kanë shënuar rritjen më të madhe gjatë tremujorit të dytë të vitit aktual thuhet në raportin “Prodhimi Vendor Bruto, tremujori i dytë 2021”, paraqitur nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK). “Tregtia me shumicë dhe me pakicë ka shënuar rritje prej 31,90-përqindësh, ndërtimtaria 27,28 për qind, aktivitetet financiare

dhe të sigurimit me 16,19 për qind, informacioni dhe komunikimi me 8,04 për qind, bujqësia, pyjet dhe peshkimi me 1,91 për qind”, thuhet në raport. Sipas ASK-së, gjatë këtij tremujori patundshmëria ka shënuar rënie. “Aktivitetet e pasurive të paluajtshme kanë shënuar rënie prej 1,10-përqindësh”, ka njoftuar ASK-ja. Kurse sipas metodës së shpenzimeve, eksporti dhe importi i mallrave e shërbimeve

shënuan rritje. “Eksporti i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar rritje prej 27-përqindësh, importi i mallrave dhe shërbimeve 53,74 për qind, formimi i bruto kapitalit 31,17 për qind dhe shpenzimet e konsumit final 14,20 për qind”, përfundon raporti. Prodhimi Vendor Bruto në këtë tremujor ka shënuar rritje reale prej 16,28-për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



Pse çmimet globale të ushqimeve, janë sot më të larta sot se kurrë më parë?



Nga Alastair SMITH
"The Conversation"

Këtë muaj çmimet globale të ushqimeve u rritën me gati 33 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo shifër raportohet nga Indeksi i përmuajshëm i Çmimeve të Ushqimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO). Ai ka zbuluar gjithashtu se çmimet globale janë rritur me më shumë se 3 për qind, që nga korriku po i këtij viti, duke arritur nivele të papara që nga viti 2011. Indeksi i Çmimeve të Ushqimit, është krijuar për të përshkruar rezultatin e kombinuar të ndryshimeve të çmimit mbi një sërë mallrash ushqimore, përfshirë vajrat vegjetale, drithërat, mishin dhe sheqerin, duke i krahasuar ato muaj pas muaji. Ai i konvertion çmimet aktuale në një indeks, duke i krahasuar me nivelet mesatare të çmimeve midis viteve 2002-2004. Ky është burimi standard për gjurmimin e çmimeve globale të ushqimeve, të cilat nuk janë përshtatur me inflacionin specifik në vende të caktuara apo atë global. Ndërsa çmimet nominale na tregojnë koston monetare të blerjes së ushqimit në treg, çmimet e përshtatura ndaj inflacionit (ato që ekonomistët i quajnë çmime "reale"), janë shumë më të rëndësishme për sigurinë ushqimore. Pasi tregojnë sesa sa lehtë mund të kenë njerëzit qasje në ushqimet e duhura. Çmimet e të gjitha mallrave dhe shërbimeve, prirën të rriten më

shpejt se sa të ardhurat mesatare (edhe pse jo gjithnjë). Inflacioni nënkupton se jo vetëm që blerësit duhet të paguajnë më shumë për një produkt (për shkak të rritjes së çmimit të tij nominal).

Por ata kanë proporcionalisht më pak para për të shpenzuar për të, duke pasur parasysh rritjen paralele të çmimeve të gjithçkaje tjetër, përveç rrogave dhe të ardhurave të tjera. Muajin e kaluar, unë analizova Indeksin e Çmimeve të Ushqimit të FAO-s, të rregulluar sipas inflacionit, dhe zbulova se çmimet reale globale të ushqimit ishin në fakt më të larta sesa në vitin 2011, kur kriza ushqimore ndihmoi në rrezimin e qeverive autoritare në Libi dhe Egjipt.

Bazuar në çmimet reale, është aktualisht më e vështirë të blesh ushqime në tregun ndërkombëtar sesa në gati çdo vit tjetër, që kur filloi regjistrimi i çmimeve nga OKB-ja në vitin 1961. Përfshirë të vetme janë vitet 1974-1975.

Ato kulme të çmimeve ushqimore, ndodhën pas rritjes së çmimit të naftës në vitin 1973, që rriti me shpejtësi inflacionin në shumë pjesë të ekonomisë globale, përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e ushqimit. Po çfarë po e nxit sot rritjen e çmimeve të ushqimeve?

Çmimet e karburantit, moti i keq dhe Covid-19

Faktorët kryesorë nxitës të çmimeve mesatare ndërkombëtare të ushqimeve, janë gjithmonë të ndërlikuar.

Çmimet e mallrave të ndryshëm rriten dhe ulen në bazë të faktorëve universalë, por edhe atyre specifikë për çdo mall dhe çdo rajon.

Për shembull, rritja e çmimit të naftës, e cila nisi në prillin e vitit 2020, ka ndikuar në çmimet e të gjitha produkteve ushqimore në indeksin e FAO-s, duke rritur kostot e prodhimit dhe transportit të ushqimit.

Mungesat e krahut të punës që shkaktoi pandemia e Covid-19, e ka zvogëluar disponueshmërinë e punëtorëve për të kultivuar, korruar, përpunuar dhe shpërndarë ushqime, që përbën një tjetër arsye universale të rritjes së çmimit të mallrave ushqimore. Në fakt, çmimi mesatar real i ushqimeve është rritur që nga viti 2000, duke përmbysur trendin e mëparshëm të një rënieje të qëndrueshme nga fillimi i viteve 1960. Pavarësisht përpjekjeve globale – të cilat pjesërisht kanë lidhje me objektivat e përcaktuara nga Zhvillimi i Mijëvjeçarit i OKB-së ashtu edhe nga Synimet e Mëvonshme të Zhvillimit të Qëndrueshëm për të zvogëluar urinë – çmimet e kanë bërë ushqimin në mënyrë të qëndrueshme më pak të arritshëm për shumë popullata. Asnjë produkt i vetëm, nuk ka qenë vazhdimisht përgjegjës për rritjen mesatare të çmimit real që nga viti 2000. Por indeksi i çmimeve të drithërave nga të cilat prodhohet vaj, është rritur ndjeshëm që nga marsi i vitit 2020, i nxitur kryesisht nga rritja e çmimit të vajrave vegjetale në mbi 16.9 për qind midis viteve 2019-2020.

Sipas raporteve të FAO-s, kjo ndodhi për shkak të kërkesës në rritje për bio-naftën dhe motit të pafavorshëm. Kategoria tjetër e ushqimeve, që ndikon më shumë në rritjen e përgjithshme të çmimit të ushqimeve është sheqeri. Këtu faktori kryesor është sërish moti i pafavorshëm, përfshirë dëmtimet nga ngricat në Brazil, gjë që ka reduktuar eksportet duke rritur ndjeshëm çmimet.

Drithërat kanë pasur më pak ndikim në rritjen e përgjithshme të çmimeve. Por qasja ndaj tyre në të gjithë botën, është veçanërisht e rëndësishme për sigurinë ushqimore. Gruri, elbi, misri, sorgumi dhe orizi, përbëjnë të paktën 50 për qind të ushqimit global, dhe deri në 80 për qind të ushqimit në vendet më të varfra. Rezervat globale të këtyre të lashtave, janë zvogëluar që nga viti 2017, pasi kërkesa e ka tejkaluar ofertën. Zbrazja e dyqaneve, ka ndihmuar në stabilizimin e tregjeve globale, por çmimet janë rritur ndjeshëm që nga viti 2019.

Sërish, arsyet e këtyre luhatjeve janë të ndërlikuara. Por diçka që meriton vëmendje ka të bëjë me numrin e herëve që nga viti 2000, kur "moti i paparashikueshëm dhe i pafavorshëm" është raportuar nga FAO si shkaktari i "prishmërive të ulëta mbi të korrat", "të korrave të dëmtuara nga moti" dhe për "rënie të prodhimit".

Evropianët mund të shqetësohen për çmimin e makaronave, teksa thatësira e gjatë në Kanada gjatë këtij viti ka dëmtuar shumë të korrat e grurit. Por, ndërsa indeksi

real i çmimeve të drithërave, është afër niveleve që përshkallëzuan trazirat mbi çmimin e bukës, në kryengritje të përgjithshme në vitin 2011, ekziston një nevojë edhe më emergjente për t'u marrë parasysh, se si komunitetet në rajonet më pak të pasura, mund t'i përballojnë këto sfida duke shmangur trazirat.

Kapaciteti teknologjik si dhe organizimi ynë socio-ekonomik, nuk mund të menaxhojnë dot me sukses motin e paparashikueshëm dhe të pafavorshëm. Tani është momenti i duhur që të mendohet se si do të furnizohemi me ushqime në një botë më të ngrohtë, me më shumë se 2 gradë Celcius, një rezultat që sipas raportit më të fundit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike konsiderohet tashmë gjithnjë e më i mundshëm.

Pa ndërmarrë ndryshime rrënjësore, degradimi i klimës do të vazhdojë duke e zvogëluar qasjen ndërkombëtare tek ushqimet e importuara, përtej çdo precedenti të mëhershëm në histori. Çmimet më të larta do ta zbehin ndjeshëm sigurinë ushqimore, dhe nëse ekziston një ligj i qëndrueshëm i shkencave sociale, ai është se njerëzit e uritur ndërmarrin shpesh hapa radikalë për të siguruar jetesën e tyre, dhe sidomos aty ku perceptohet se udhëheqësit kanë dështuar.

Shënim: Alastair Smith, anëtar i Qendrës për Zhvillimin e Qëndrueshëm Global, Universiteti Uoruk, Britania e Madhe.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita 'fikët' në Klinë, Prishtina ndalet nga Ulpiana

Kampionia dhe nënkampionia e Superligës, Prishtina dhe Drita, nuk ia kanë arritur synimeve në ndeshjet e javës së shtatë. Kryeqytetasit në stadiumin "Fadil Vokrri" janë ndalur në barazim nga Ulpiana, kurse Drita ka pësuar humbje në Klinë nga Dukagjini. Vendasit, edhe pse luajtën pa një lojtar përgjatë 31 minutave, në fund morën tri pikë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Java e shtatë e BKT Superligës në futboll është mbyllur me befasi, pasi dy skuadrat pretendente për titull, Prishtina dhe Drita, nuk kanë arritur fitore në përballje me Ulpianën, përkatësisht Dukagjinin e Klinës. Kampionia në fuqi e Kosovës, Prishtina, ka bërë edhe një lëshim tjetër në këtë edicion garash, pasi nuk ka arritur të marrë më shumë se një pikë nga përballja me Ulpianën (1-1). Prishtina dominoi në pjesën e parë, por ishte skuadra mysafire ajo që në minutën e dytë shtesë realizoi nëpërmjet

Ermir Rezit. Kryeqytetasit e nisën mirë pjesën e dytë dhe e barazuan rezultatin në minutën e 54-t me golin e Leotrim Kryeziut. Në dymbëdhjetë minutat e fundit Prishtina luajti me një lojtar më pak pasi u përjashtua nga loja Karabeci. Ndeshja përfundoi 1-1. Prishtina, pas shtatë xhirove, ka grumbulluar 9 pikë dhe renditet në vendin e gjashtë, kurse Ulpiana ka 6 pikë dhe renditet në vendin e nëntë. Skuadra e Dukagjinit e ka mposhtur Dritën e Gjilanit me rezultat 2-1. Në minutën e 39 Almir Ajzeraj e kaloi skuadrën mysafire në epërsi 0-1. Pesë minuta pasi filloi pjesa e dytë, Dukagjini u rikthye



në lojë me golin e bukur të shënuar nga Ahmed Januzi (1-1). Nëntë minuta më vonë Basriu i vendasve u ndëshkua me karton të kuq dhe gjërat u vështirësuan për Dukagjinin. Pavarësisht prej epërsisë numerike, Drita nuk arriti të shënojë golin e fitores dhe, në anën tjetër, tre minuta pa përfunduar ndeshja pranoi golin e humbjes, të cilin e realizoi Henry Chibueze. Kjo fitore është

shumë e vlefshme për skuadrën që drejtohet nga Armend Dallku, pasi tash ka gjashtë pikë dhe renditet në vendin e tetë në tabelë. Në anën tjetër, nënkampionët e Dritës e lëshuan rastin të marrin kryesimin e Superligës, derisa renditen në vendin e pestë me 11 pikë. Në vendin e parë është Drenica, e cila të mërkurën e mposhti Malishevën. Fitores në

këtë xhiro i është gëzuar edhe Gjilani në përballje me Llapi (2-1), kurse Ballkani ndau pikët në përballje me Feronikelin (0-0).

BKT SUPERLIGA	
Dukagjini - Drita	2-1
Prishtina - Ulpiana	1-1
Drenica - Malisheva	1-0
Ballkani - Feronikeli	0-0
Gjilani - Llapi	2-1

Tabela	
	Pikë
1. Drenica	14
2. Ballkani	13
3. Gjilani	12
4. Malisheva	11
5. Drita	11
6. Prishtina	9
7. Feronikeli	7
8. Dukagjini	6
9. Ulpiana	6
10. Llapi	3

Në xhiron e radhës takohen: Ballkani-Drenica, Malisheva-Gjilani, Drita-Prishtina, Llapi-Dukagjini, Feronikeli-Ulpiana.

Berisha përgëzon KOK-un për sukseset e xhudisteve në Lojërat Olimpike



PRISHTINË, 30 SHTATOR - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Ismet Krasniqi, ka pritur sot futbollistin e mirënjohur Besart Berisha. Ish-lojtari i Kombëtares së Shqipërisë dhe Kosovës është kthyer në vendlindje, me ç'rast javë më parë nënshkroi kontratë me klubin më të madh në vend, FC Prishtina. Presidenti Krasniqi, duke falënderuar Berishën për vizitën, vlerësoi lart të arriturat e tij si lojtar, duke thënë se Berisha e ka përfaqësuar në mënyrën më të mirë vendin tonë, veçanërisht gjatë karrierës së suksesshme në

Australi, ku theu rekordet duke u bërë golashënuesi më i mirë në histori të këtij vendi. Ndërsa Berisha falënderoi presidentin Krasniqi për pritjen dhe shprehu mirënjohjen për të arriturat e KOK-it, me theks të veçantë medaljet e arta olimpike të fituara në "Rio 2016", veçanërisht në "Tokio 2020". Në fund, presidenti Krasniqi i dhuroi një fanellë të ekipit olimpik të Kosovës që mori pjesë në "Tokio 2020", si dhe librin fotoreportazh "Debutimi i Artë", kushtuar kampiones olimpike Majlinda Kelmendi.

FHK-ja pritët të bashkëpunojë me Akademinë e njohur daneze

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në konkurrencë të femrave, Agron Shabani, ka vizituar akademinë e njohur të hendbollit në Danimarkë, Skjern. Me këtë rast, me drejtuesit e akademisë daneze Shabani është pajtuar për fillim të bashkëpunimit. Tani pritët vendimi i bordit të FHK-së për ta zyrtarizuar bashkëpunimin me danezët. Në Akademinë Skjern, selektori Shabani është pritur nga Jan Ole Kristensen, kryesues i Akademisë dhe trajneri i ekipit të parë të klubit Skjern, Claus Dalgaard Hansen. Ky ekip garon në elitën daneze. Në këtë

Akademi hendbollin e kanë përsosur dy lojtaret e Kosovës, Marigona e Arlinda Hajdari. "Kjo Akademi më shumë punon për përsosjen e lojtarëve. Do të thotë, punohet për përmirësimin e elementeve të ndryshme të lojtarëve, varësisht se ku ata kanë nevojë. Në Akademi ka edhe dhoma ku banojnë lojtarët që vijnë nga larg apo edhe nga vende të tjera. Punohet nga mosha e re, ndërsa janë të angazhuar disa trajnerë për fëmijë dhe të rritur. Vizita është bërë e mundur përmes motrave Hajdari. Drejtuesit e Akademisë kanë ofruar bashkëpunim me Federatën e



Hendbollit të Kosovës. Parimisht jemi pajtuar që disa trajnerë të rinj kosovarë të qëndrojnë për vizitë në këtë Akademi të njohur në Danimarkë. Trajnerët tanë do të vendosen në hapësirën e Akademisë dhe do ta përcjellin nga afër punën që bëhet atje. Po ashtu, këta dy ekspertë danezë janë të gatshëm të vijnë në Kosovë dhe të kontribuojnë për zhvillimin e hendbollit në vendin tonë", ka thënë Shabani. Të kujtojmë që Danimarka është prej vendeve me hendbollin më të zhvilluar në botë, sidomos puna me fëmijë dhe të rinj është e nivelit më të lartë.

Ronaldo: Dua ta bëj përsëri historinë me Unitedin

MANCHESTER, 30 SHTATOR - Cristiano Ronaldo i ka falënderuar tifozët e Manchester Unitedit që i ndihmuan ekipit gjatë fitores dramatike 2-1 kundër Villarrealit në Ligën e Kampionëve. Portugezi ka thënë se është i gatshëm ta shkruajë përsëri historinë me klubin.

Unitedi fitoi me përmbysje të rezultatit falë golave nga Alex Telles dhe Ronaldo, pasi Villarreali kishte kaluar në epërsi në fillim të pjesës së dytë në "Old Trafford". "Tani çdo gjë është e mundur, çdo gjë është e hapur dhe ne besojmë se do të kalojmë tutje. Kjo është arsyeja pse u

ktheva këtu. Më mungoi shumë ky klub. Bëra historinë me këtë klub dhe dua ta bëj përsëri", ka thënë Ronaldo. "Falënderoj tifozët, jo vetëm për mua, por për përkrahjen e ekipit, gjë që do të jetë shumë e rëndësishme këtë sezon në veçanti", ka shtuar Ronaldo.



Konfirmohen skuadrat për edicionin e ri në Ligën Unike

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Edicioni i ri në Ligën Unike pritet të jetë mjaft interesant. Tashmë janë konfirmuar të gjitha skuadrat për edicionin e ri. Për edicionin 2021-2022 në konkurrencën e meshkujve kanë konfirmuar pjesëmarrjen: Golden Eagle Ylli, Prizreni 16, Rahoveci dhe Peja nga Kosova dhe Vllaznia, Kamza, Tirana Neptun dhe Teuta nga Shqipëria. Fillimisht do të mbahet Superkupa Mbarëkombëtare në të dyja konkurrencat, më pas edicioni i ri që pritet të fillojë në fund të muajit tetor. Në edicionin e kaluar kampion ishte shpallur Golden Eagle Ylli. Turneu ishte zhvilluar në formë të Final 8 për shkak të pandemisë me Covid-19. Megjithatë, në këtë edicion tetë skuadrat më të mira nga Kosova dhe Shqipëria do të garojnë për t'u shpallur kampione. Në konkurrencën e meshkujve Liga Unike do të zhvillohet me sistem të dyfishtë vajtje-ardhje në edicionin 2021-2022. Pas përfundimit të 14



xhirove të rregullta në konkurrencën e meshkujve, vendet 1-2 kualifikohen direkt për Final 4, ndërsa vendet 3-6 dhe 4-5 luftojnë për vendin e tyre në Final 4 përmes dy ndeshjeve kualifikuese vajtje-ardhje, në të cilat takohen ekipet 3-

6 dhe 4-5. Skuadra e cila nxjerr rezultat më të mirë nga dy ndeshjet e zhvilluara (pikët e shënuara në total nga dy ndeshjet) do të jetë gjysmëfinaliste. Ekipet më mirë të renditura luajnë si vendase në ndeshjen e kthimit.

Syla: Nuk udhëtojmë me flamur të bardhë

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Superkupa e Femrave do të vë përballë skuadrat më të mira për momentin në basketbollin femëror. Sfidat do të zhvillohen më 4 dhe 5 tetor në Pejë, ku Penza do të përballë me Vëllaznimin, kurse Prishtina me Bashkimin. Finalja zhvillohet më 5 tetor. Trajneri i Vëllaznimit, Pal Syla, është shprehur se, edhe pse nuk e kanë skuadrën si në edicionin e kaluar, nuk udhëtojnë me flamur të bardhë. "Për dallim nga edicioni i kaluar, kemi bërë disa ndryshime. Ne jemi munduar të përgatitemi sa më mirë për Superkupë, që është shumë e rëndësishme. Sigurisht nuk udhëtojmë me flamur të bardhë dhe do të mundohemi të japim më të mirën tonë kundër Penzës. Angazhimi nuk do të mungojë dhe do të mundohemi të japim më të mirën në gjysmëfinale të Superkupës", ka thënë Syla për faqen zyrtare të FBK-së. Skuadra kuqezi edicionin e kaluar ishte befasia e këndshme në elitën e



femrave, sidomos në stinorin vjeshtor, kurse garat e rregullta i përfundoi me 12 fitore dhe tetë humbje, ndërsa në "play-off" u mposht nga Bashkimi. Ndeshja Penza-Vëllaznimi zhvillohet më 4 tetor me fillim nga ora 16:00.

SHKURT

Leclerc: Vend i 15-të është një dështim

Vendi i 15-të në garën e fundit në Rusi ka zhgënjyer pa masë pilotin monogas të Ferrarit, Charles Leclerc. Ai synonte një pozicion tjetër, sidomos kur situata u përmbys për shkak të shiut që nisi në pistë. Nga kjo situatë përfitoi vetëm shoku i tij i skuadrës, Carlos Sainz, që u renditi i treti. "Ende nuk më ka kaluar zhgënjimi për atë rezultat. Mund të kishim marrë një vendim më të mirë gjatë asaj gare, por makina nuk ishte ajo që unë shpresoja. Shpresoj që të gjithë të mësojmë nga kjo që na ndodhi, pasi vend i 15-të është një dështim", u shpreh Charles Leclerc.

De Jong: Ndryshimi i trajnerit nuk e zgjidh situatën te Barça

Barcelona pësoi një tjetër humbje turpërore në Ligën e Kampionëve ndaj Benficës me rezultatin 3-0. Frenkie de Jong pranon se skuadra katalanase ka një problem, por nuk beson se zgjidhja qëndron në shkarkimin e Ronald Koeman. "Është një moment i vështirë tani. Në pjesën e parë ne nuk kemi luajtur keq. Ne krijuam rrezik, por nuk shënuam. Pas golit të dytë loja ishte e hapur dhe ne nuk kemi qenë mirë. Unë mendoj se ne ishim të fokusuar që në fillim. Ishte një moment pa fat, por ata nuk duhet të na shënonin aq shpejt. Kanë mbetur edhe disa ndeshje dhe nëse i fitojmë ato të mbetura, ka një shans. Unë jam ende i bindur se mund të kalojmë fazën e grupeve. Ne duhet të vazhdojmë të luftojmë, të jemi së bashku, ta kapërcejmë këtë situatë dhe të arrijmë të dalim prej saj kur punojmë shumë dhe jemi të bashkuar si ekip. Nuk mund të flas për Koeman, nuk është për mua. Unë nuk mendoj se ndryshimi i trajnerit mund të zgjidhë gjë", ka thënë De Jong.

Mata vendos të largohet nga Unitedi

Juan Mata pritet të largohet nga Manchester Unitedi pas 9 sezonesh. Spanjoli i cili rinovoi gjatë verës edhe për një sezon me "djajtë e kuq", numëron me gishta aktivizimin në formacion dhe për shkak të hapësirave të pakta pritet që të largohet që në merkaton e dimrit. Për Solskjaer nuk ka vend në formacion për fantazistin spanjoll i cili ka luajtur vetëm në Carabao Cup kundër West Ham, por edhe aty ekipi u eliminua ndaj dhe nuk pritet të ketë më shanse për të. Disa ekipe angleze dhe spanjolle janë gati ta mirëpresin 34-vjeçarin në janar.

UEFA pezullon gjyqtarin turk

Një nga ndeshjet kryesore të xhiros së dytë në Ligën e Kampionëve ishte ajo në mes të AC Milanit dhe Atletico Madridit. Skuadra spanjolle triumfoi në fund, me përmbysje të rezultatit, nga 0-1 në 2-1. Por, ndoshta fajtori kryesor për këtë rezultat ishte gjyqtari turk Çunejt Çakir, që bëri disa vendime skandaloze. Së pari, e largoi Kessien direkt me të kuq, duke i lënë "Rossonerët" me 10 lojtarë në fushë. Ndërsa në fundin e takimit, akordoi penallti për Atletico pa shikuar VAR-in, me anë të së cilës skuadra spanjolle i arkëtoi pikët e plota. Milani dërgoi ankesë zyrtare në UEFA dhe kjo ka ndikuar që shtëpia më e madhe e futbollit ta pezullojë arbitrin turk. Sipas "Gazzetta dello Sport", gjyqtari Çunejt Çakir është suspenduar për një kohë të gjatë.

Tucheli: Dukemi shumë të zotë por, me sa duket, nuk jemi

Thomas Tuchel ishte i tërbuar pas humbjes së djeshme me Juventusin dhe këtë nuk ngurroi që ta shprehë me tone të ashpra për "BT Sport". Trajneri gjerman i Chelsea duket se ka shtuar edhe më tej mllëfin e akumuluar që nga humbja me Cityn në kampionat duke

konfirmuar: "Kur mendoj që në 15 minutat e para thjesht e kishim forcuar Juven që të mblidhej e gjitha në 16-20 metra dhe të mos i linim asnjë top që të prekte, prisja që në fund të merrnim shumë herë më shumë sesa zero pikë. Edhe pse hapësira kishte për t'u

shfrytëzuar më mirë, nuk arrij të kuptoj se si nuk arritëm ta detyrojmë ritmin e lojës sonë dhe të rritnim intensitetin me kalimin e kohës. Në stërvitje bëjmë gjëra shumë të mira, por duke parë rezultatet në fushë, si ndaj Cityt dhe akoma më shumë me Juventusin, kjo

do të thotë se nuk jemi aq të zotë sa dukemi. Në vend që duke pasuar topin të ishim më të shpejtë, pashë një skuadër të lodhur, shumë e ngadaltë, sidomos në mendime. Më duket e çuditshme dhe nuk di ta analizoj këtë moment tonin", ka deklaruar Tucheli.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Feniks-A" Sh.p.k. Junik, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e peletit dhe përpunimit të drurit në Z.K. Junik, Komuna e Junikut Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.10.2021 në ora 10:00 në Zyret e kompanisë Feniks-A shpk e cila gjendet në rrugën Agim Ramadani në Junik do të organizohet debat publik nga Kompania " Feniks-A" Sh.p.k. Junik, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e peletit dhe përpunimit të drurit në Z.K. Junik, Komuna e Junikut

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcKxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Feniks-A" Sh.p.k. Junik për fabrikën për prodhimin e peletit dhe përpunimit të drurit në Z.K. Junik, Komuna e Junikut

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Thirrje për aplikim

Doni Fruits Sh.P.K, NUI 8102380263, po kërkon ofertues /kontraktor/ kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/ propozim për:

"Zgjerim i objektit ekzistues dhe instalim i dhomave (komoreve) me temperaturë të kontrolluar +6 C"

Nr. Prokurimit MBPZHR/AZHB 01/21.

Emri: Doni Fruits Sh.P.K

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: bekim.sinani@donifoods.com

Adresa: Zona industrial, Shtime, Kosovë

Tel: +383 (0)49 971 000

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, **ora 14:00**, në zyrat e kompanis - Adresa: Zona industrial, Shtime, Kosovë



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Granit Elezkurta shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

▶ Hasan Kolgeci shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Jetmir Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Mic Sokoli " Lubeqev.

▶ Besnik Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Dy Dëshmoret " Pirane.

▶ Alma Katona shpall të pavlefshme diplomën e kolegjit AAB Bachelor gjuhe Angleze nr. 534/14 në Prishtinë.

▶ Alma Katona shpall të pavlefshme diplomën e kolegjit AAB master e gjuhës Angleze nr. 073/17 në Prishtinë.

▶ Lazer Quni shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "At Gjergj Fishta KK Gjakovënga kl. I-VIII.

▶ Dritan Syla shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III ,IV Gjakovë.

▶ Nurije Dragusha shpall të pavlefshme dëftesën e kl. VIII të shkollës fillore "Nexhmi Mustafa" Prugocv komuna Prishtinës.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpijan kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpijana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

